



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së njëmbëdhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 23.9.2013, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Tefik Mehmeti, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Në mbledhje morën pjesë edhe Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore dhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësuesit e kompanive projektuese të planeve rregulluese dhe përfaqësuesi i OSBE-së..

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Propozimplani rregullues urban Prishtina e re – Lindje”;
2. Propozimplani rregullues urban Prishtina e re – Qendër”;
3. Propozimplani rregullues urban Prishtina e re – Perëndim”;
4. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2104 dhe kornizes afatmesme buxhetore 2014- 2016;
5. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Stacionit policor “Jugu” në Prishtinë;
6. Informatë për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të komunës së Prishtinës, për vitin shkollor 2012/2013;
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Lidhur me tri planet rregulluese urbane Prishtina e re Lindje, Qendër dhe Perëndim, Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit tha se këto plane janë miratuar si projekte. Këto plane rregulluese kanë qenë në debat publik, ku janë dhënë vërejtje dhe pas debatit disa nga ato vërejtje nga komisioni janë marrë si të arsyeshme dhe janë inkorporuar në draftin final. Kërkoj nga përfaqësuesit e kompanive që ti prezantojnë vetëm ato ndryshime të cilat janë bërë.

Bujar Demjaha, përfaqësues nga kompania projektuese në pika të shkurtëra bëri prezantimin e këtij plani në mënyrë elektronike duke elaboruar vetëm për ato ndryshime të cilat janë bërë në bazë të vërejtjeve, e që nga Komisioni janë marrë si të arsyeshme.

Tefik Mehmeti tha se vërehet një dallim i madh rreth koeficientit të etazhitetit kryesisht afër autostrades.

Kryesuesi gjithashtu shprehu një rezervë duke cekur se te zona ku figuron P+2 është pak si e pa qartë, andaj si do të kompenzohen ata pronarë, të shihet mundësia që të përafrohen këta koeficienta te ndërtimit (P+10, P+6 dhe P+2).

Behxhet Musliu tha se këta koeficienta janë harmonizuar me Planin zhvillimor urban.

Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit tha se në boshtin e qytetit etazhiteti i ndërtimeve është paraparë të jetë më i lartë, kështu që në ramje të jetë më i vogël.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimplanin rregullues urban Prishtina e re – Lindje” dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimplanin rregullues urban Prishtina e re – Qendër”, Driton Ileshi, përfaqësues nga kompania projektuese në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij plani duke elaboruar vetëm për disa ndryshime rreth destinimit të sipërfaqeve të ndryshme qenësore.

Burbuqe Hydaverdi u fokusua kryesisht rreth disa ankesave të qytetarëve.

Behxhet Musliu tha se vija e tramvajit e cila është e paraparë me këtë plan, propozoi që ajo të hiqet, pasi që komisioni e ka aprovuar heqjen e saj.

Mustafë Krasniqi tha se janë dy propozime për tramvajin dhe cili do të ishte më i realizueshmi. Po ashtu kërkoi të dijë se disa rrugë kanë mbetur të pa prekura e disa të tjera kanë kaluar nëpër pronat private andaj duhet të mendohet se si të veprojmë me këto prona ose ti fusim në koeficientat e ndërtimit. Gjithashtu për pjesën lindore të kësaj zone a është bërë ndonjë analizë e koeficientit të ndërtimit.

Aziz Pacolli shtroi pyetjen se në cilin drejtim e ka vijen treni urban dhe kërkoi që të bëhet harmonizimi mes zonave në bazë të koeficientit.

Hazir Zhitja, përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit tha se sa i përket harmonizimit të zonave, duhet shikuar mundësinë që të shkohet me një variant për vijen e trenit.

Shemsi Veseli tha se mungesa e një plani të mirëfilltët strategjik, si dhe gjendja aktuale në terren kanë ndikuar që këto tri plane të jenë jo të mira. Po ashtu si problem edhe çështja e zbatimit të Panit zhvillimor urban etj, kur dihet se planifikimi bëhet në interes të qytetarit. Çështje tjera që ndikojnë në këto plan janë edhe ndërtimet pa leje e që nuk po ka një formë se si të zgjidhen ato probleme. Për vijen e propozuar të trenit, propozoi që të jepet një variant më i mirë. Me gjithat përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve, uroi që ky plan të jetë mbi 50% i zbatueshëm.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimplanin rregullues urban "Prishtina e re - Qendër" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimplanin rregullues urban Prishtina e re - Perëndim", Lulëzim Kabashi, përfaqësues nga kompania projektuese në mënyrë elektronike bëri prezantimin këtij plani duke elaboruar vetëm për disa ndryshime kryesisht në infrastrukturën rrugore dhe në hapësirat gjelbëruese.

Flora Mazreku, përfaqësuese nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndertimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit tha se nuk pajtohem rreth disa koeficienteve të ndërtimit në bazë të ngastrave pra duhet të jetë një planifikim i qëndrueshëm.

Mustafë Krasniqi tha se është shqetësim i disa pronarëve për disa prona te hapësira për afarizëm dhe është si e pa pranueshme për ata. Po ashtu edhe çështje tjetër për koeficientët e ngritur enormë.

Aziz Pacolli tha se për numrin e etazheve nëntokësore pse të thuhet nuk kufizohen. Lidhur me ndryshimin e vijes së unazes, **Burbuqe Hydaverdi** dha sqarime të nevojshme.

Shemsi Veseli tha se cili është ai organ që ka përcaktuar koeficientat e ndërtimit si dhe çështje tjetër e që është shqetësuese për këtë zonë është edhe degradimi i lagjes etj.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimplanin rregullues urban Prishtina e re - Perëndim dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2104 dhe kornizes afatmesme buxhetore 2014- 2016, në pika të shkurtëra të pranishmit i informoi **Xhelil Bektashi**, drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Pronë.

Tefik Mehmeti tha se sipas kësaj kornize shihet se granti për shëndetësi është ulur shumë dhe kërkoi të dijë se pse është vepruar ashtu.

Azisi Pacolli tha se granti specifik për Drejtorinë e Shëndetësisë është ulur shumë dhe se kjo drejtori a ka paraparë ndonjë alternativë tjetër për mbulimin e shpenzimeve të saja.

Shemsi Veseli tha se për miratimin e këtij dokumenti është dashtë që të mbahen disa debate. Për këtë material kam disa sugjerime si p.sh, te hyrat vetanake ka mundur të jetë një shumë e mjeteve më e planifikuar, të hyrat nga shfrytëzimi i sipërfaqeve janë shuma të vogla.

Po ashtu te Drejtoria e Shëndetësisë, të hyrat janë planifikuar shumë pak e në fakt aty ka të hyra më të mëdha.

Lidhur me grantin për shëndetësi, **Avdullah Hoti** dha sqarime të nevojshme.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2104 dhe kornizes afatmesme buxhetore 2014- 2016 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Stacionit policor “Jugu” në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të komunës së Prishtinës, për vitin shkollor 2012/2013 dhe i dërgohet kuvendit për shqyrtim.

Mbledhja mbaroi në orën 16:20.

Procesmbajtësi

Zijadin Gashi

KRYESUESI I KOMITETIT

Sami Hamiti, ecc.i dipl.